THIRRJE PËR APLIKIM **PIKSH 2027**

PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR

00

Thirrje për financimin e PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR – PIKSH 2027
Vendimi i Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit Nr. 28 datë 21.09.2026 "Për miratimin e Udhëzuesit për menaxhimin e projekteve PIKSH dhe hapjen e thirrjes në kuadër të Programit Kombëtar PIKSH 2027"

Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit hapin thirrjen për financimin e PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR – PIKSH 2027, për mbështetjen e projekteve që krijojnë, modernizojnë, zgjerojnë, integrojnë ose funksionalizojnë infrastrukturën e kërkimit shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë. Thirrja mbështet investime që rrisin cilësinë, kapacitetin dhe konkurrueshmërinë e kërkimit, përmirësojnë përdorimin e përbashkët të burimeve dhe krijojnë ndikim të qëndrueshëm institucional e kombëtar.
Financimi jepet për infrastrukturë kërkimore dhe jo për realizimin e projekteve kërkimore të mirëfillta. Çdo propozim duhet të provojë nevojën e investimit, përdorimin shkencor, realizueshmërinë teknike, arsyeshmërinë financiare, aksesin e hapur dhe qëndrueshmërinë pas përfundimit të financimit.

TË DHËNAT KRYESORE TË THIRRJES

	PROGRAMI KOMBËTAR - PIKSH 2027
AUTORITETI FINANCUES	Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, AKKSHI
FONDI I PËRGJITHSHËM – VITI 2027	633.980.400 lekë
FINANCIMI MAKSIMAL PËR PROJEKT	Nuk ka kufizim
KOHËZGJATJA E PROJEKTIT	12 -21 muaj
HAPJA E THIRRJES	[20.11.2026]
AFATI I FUNDIT	[05.02.2027] ora [10:00]
MËNYRA E APLIKIMIT	Zyra e protokollit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë
KONTAKTI	programet.kombetare@nasri.gov.al | www.nasri.gov.al

Dokumentet e thirrjes dhe njoftimet zyrtare publikohen në faqen zyrtare të AKKSHI-së. Aplikimet pas afatit nuk pranohen, përveç një shtyrjeje të shpallur zyrtarisht për të gjithë aplikantët.

01

Qëllimi dhe objekti i thirrjes

Programi PIKSH përfaqëson një instrument të ri strategjik për zhvillimin e sistemit kombëtar të kërkimit shkencor, duke e trajtuar infrastrukturën kërkimore jo vetëm si një mbështetje teknike për aktivitetet shkencore, por si një investim strategjik publik që krijon kapacitete të qëndrueshme, mundësi bashkëpunimi dhe avantazh konkurrues për vendin.

Ndryshe nga skemat tradicionale të financimit të projekteve kërkimore, PIKSH nuk synon financimin e realizimit të një studimi apo aktiviteti kërkimor të kufizuar në kohë, por mbështet:

- krijimin e kapaciteteve të reja infrastrukturore;
- të krijojë ose përmirësojë laboratorë, qendra, platforma, pajisje dhe shërbime kërkimore me përdorim të dokumentuar;
- mirëmbajtjen, funksionimin dhe shfrytëzimin afatgjatë të investimeve publike;
- të shmangë fragmentimin dhe mbivendosjen e investimeve, duke nxitur përdorimin e përbashkët dhe partneritetet
- krijimin e platformave të përbashkëta kërkimore;
- të mbështesë prioritetet kombëtare të shkencës, teknologjisë, inovacionit dhe specializimit inteligjent;
- zhvillimin e shërbimeve shkencore dhe teknologjike për komunitetin kërkimor.

Në këtë kuadër, infrastruktura e kërkimit shkencor përfshin:

- laboratorë dhe qendra kërkimore;
- pajisje dhe instrumente shkencore të avancuara;
- infrastruktura dixhitale dhe kapacitete për shkencën e hapur;
- platforma dhe rrjete kërkimore;
- baza të të dhënave dhe shërbime të specializuara shkencore;
- infrastruktura mbështetëse për zhvillimin e kërkimit ndërdisiplinor.

Një nga risitë themelore të Programit PIKSH është orientimi drejt krijimit të infrastrukturave kërkimore madhore, të qendërzuara dhe strategjike, të cilat tejkalojnë kufijtë institucionalë dhe shërbejnë si kapacitete kombëtare për komunitetin shkencor.

Nëpërmjet kësaj qasjeje, PIKSH synon të kalojë gradualisht nga financimi i investimeve të fragmentuara drejt mbështetjes së infrastrukturave:

- me rëndësi strategjike kombëtare;
- me përdorim të përbashkët ndërinstitucional;
- me masë kritike të mjaftueshme për kërkim konkurrues;
- të integrueshme në rrjete dhe iniciativa evropiane të kërkimit.

Kjo qasje synon të krijojë një bazë për zhvillimin e infrastrukturave kombëtare prioritare në fusha me rëndësi për zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe shoqëror të vendit.

02

BAZA LIGJORE

Kuadri rregullator për këtë program financimi të AKKSHI-së është përcaktuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; Ligjin nr. 109/2024, datë 19.12.2024, "Për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse;
Vendimin Nr. 607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit".
Thirrja është në përputhje me VKM Nr. 666, datë 12.11.2025 "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026–2028", të rishikuar;
Vendimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI Nr. 7, datë 04.05.2026 "Për miratimin e Planit të punës të vitit 2026 të veprimtarisë së AKKSHI";
Vendimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit Nr. 28 datë 21.09.2026 "Për miratimin e Udhëzuesit për menaxhimin e projekteve PIKSH dhe hapjen e thirrjes në kuadër të Programit Kombëtar PIKSH 2027".

03

Fushat dhe llojet e projekteve të mbështetura

Thirrja është e orientuar drejt prioriteteve kombëtare në fuqi për kërkimin, teknologjinë, inovacionin dhe Strategjinë e Specializimit Inteligjent, në përputhje me objektivat e integrimit të Shqipërisë në Zonën Evropiane të Kërkimit (European Research Area – ERA), duke reflektuar parimet evropiane për zhvillimin dhe menaxhimin e infrastrukturave kërkimore.

FUSHA PRIORITARE	
1. Biodiversiteti dhe Mjedisi	Ndryshimet klimatike dhe rezilienca; biodiversiteti, ekosistemet dhe restaurimi i natyrës; ndotja dhe ekonomia qarkulluese; burimet natyrore dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës; mjedisi detar dhe bregdetar; monitorimi mjedisor
2. Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	Bujqësia e qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës; bujqësia precize dhe digjitale; siguria ushqimore; bioteknologjia dhe burimet gjenetike; bioekonomia; teknologjitë ushqimore dhe ushqyerja
3. Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore	Shëndeti publik dhe parandalimi; sëmundjet kronike dhe plakja e shëndetshme; sëmundjet infektive dhe rezistenca antimikrobike; mjekësia e personalizuar dhe bioteknologjia mjekësore; shëndetësia digjitale dhe inteligjenca artificiale; shëndeti mendor
4. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Inteligjenca artificiale dhe shkenca e të dhënave; siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave; sistemet inteligjente, IoT dhe robotika; teknologjitë gjuhësore; transformimi digjital; teknologjitë e avancuara dhe kuantike
5. Shkencat Sociale, Albanologjike dhe Trashëgimia Kulturore	Albanologjia, gjuhësia dhe letërsia shqiptare; historia, arkeologjia dhe trashëgimia kulturore; etnografia, antropologjia dhe folklori; kultura dhe industritë kreative; demografia, migracioni dhe zhvillimi territorial; politikat publike, qeverisja dhe zhvillimi social
6. Uji dhe Energjia	Siguria ujore dhe cilësia e ujit; uji, klima dhe menaxhimi i rreziqeve natyrore; energjia e rinovueshme; dekarbonizimi; ruajtja e energjisë dhe hidrogjeni i gjelbër; sistemet energjetike dhe eficienca

Përputhshmëria strategjike duhet të argumentohet qartë në formularin e aplikimit. Mund të financohen projekt-propozime që përfshijnë:

- krijimin e laboratorëve, qendrave kërkimore, stacioneve eksperimentale, observatorëve ose kapaciteteve të reja kërkimore;
- modernizimin, përditësimin ose zëvendësimin e pajisjeve, instrumenteve dhe sistemeve teknologjike ekzistuese;
- zgjerimin e kapaciteteve dhe funksionaliteteve të infrastrukturës ekzistuese;
- blerjen e instrumenteve laboratorike, aparaturave analitike, sistemeve matëse dhe pajisjeve të specializuara kërkimore;
- zhvillimin e infrastrukturës digjitale, përfshirë platformat kërkimore, kapacitetet HPC, cloud, ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave, repositorët dhe infrastrukturën për shkencën e hapur;
- krijimin ose zhvillimin e laboratorëve dhe objekteve kërkimore me interes kombëtar;
- integrimin, ndërveprueshmërinë dhe rrjetëzimin e infrastrukturave ekzistuese, përfshirë lidhjen me rrjete evropiane dhe ndërkombëtare.

04

Rezultatet e pritshme dhe prioritetet

- Infrastrukturë e instaluar, e testuar dhe funksionale brenda periudhës së projektit.
- Rritje e matshme e numrit dhe larmisë së përdoruesve, institucioneve dhe grupeve kërkimore që përfitojnë nga infrastruktura, e mbështetur nga tregues performance dhe një mekanizëm institucional për mbledhjen e të dhënave të përdorimit.
- Miratim dhe zbatim i një politike për akses të hapur, transparent, të drejtë dhe jodiskriminues.
- Hartim i një plani të zbatueshëm për mirëmbajtjen, kostot operative, sigurinë dhe menaxhimin afatgjatë të infrastrukturës.
- Krijim ose mbështetje e shërbimeve, të dhënave, publikimeve, bashkëpunimeve, projekteve dhe rezultateve teknologjike.
- Zhvillim i kapitalit njerëzor në kërkim dhe inovacion, përmes rritjes së numrit dhe cilësisë së studiuesve të rinj.
- Forcim i kapaciteteve të institucioneve të arsimit të lartë, instituteve kërkimore dhe sipërmarrjeve për të zbatuar projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe për të bashkëpunuar në mënyrë sistematike universitet–industri.
- Përmirësim i cilësisë dhe ndikimit të kërkimit shkencor, përfshirë rritjen e publikimeve dhe rezultateve kërkimore sipas treguesve të matshëm të cilësisë.
- Zgjerim i transferimit të njohurive dhe teknologjisë, si dhe krijim i rezultateve shkencore, teknologjike dhe industriale.
- Zhvillim i kapaciteteve kombëtare në fushat prioritare dhe promovim i integritetit shkencor, shkencës së hapur dhe menaxhimit të përgjegjshëm të të dhënave.
- Nxitje e pjesëmarrjes dhe bashkëfinancimit nga sektori privat.
- Përparësi në financim për projektet me ndikim të lartë shkencor dhe ekonomik.
- Kontribut në përmirësimin e performancës së Shqipërisë në Tabelën Evropiane të Inovacionit dhe në raportimin e treguesve përkatës TEI.

05

Aplikantët e pranueshëm

Të drejtën për të aplikuar e kanë institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si aplikant individual ose si institucion koordinator i një partneriteti.

Aplikimi mund të paraqitet:

a. nga një institucion i vetëm - institucion publik i arsimit të lartë; ose
b. nga një partneritet i përbërë nga dy ose më shumë institucione të arsimit të lartë, ku të paktën njëri nga partnerët duhet të jetë institucion publik i arsimit të lartë dhe njëkohësisht institucioni koordinator.

Aplikanti duhet:

a. të jetë i regjistruar dhe të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi;
b. të mos jetë në procedura falimentimi, likuidimi, shpërbërjeje ose në ndonjë procedurë tjetër ligjore që cënon aftësinë për zbatimin e projektit;
c. të ketë kapacitete të përshtatshme administrative, teknike dhe financiare për menaxhimin dhe zbatimin e projektit;
d. të caktojë një person përgjegjës për projektin, i cili shërben si pikë kontakti me AKKSHI dhe përgjigjet për koordinimin e aktiviteteve të projektit;
e. të ketë kapacitete institucionale për administrimin, mirëmbajtjen, funksionimin dhe përdorimin afatgjatë të infrastrukturës së financuar;
f. të mos ketë detyrime të papërmbushura financiare, kontraktuale ose raportuese ndaj AKKSHI nga projekte të mëparshme të financuara, përveç rasteve kur këto janë në proces të rregullt zgjidhjeje;
g. të garantojë saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në aplikim.

Një institucion publik i arsimit të lartë mund të marrë pjesë në më shumë se një aplikim, si aplikant ose partner, me kusht që secili projekt të jetë i dallueshëm në objekt, qëllim dhe plan investimi dhe të mos krijojë mbivendosje të financimit për të njëjtat aktivitete ose asete infrastrukturore.

06

Partneritetet

Aplikimet mund të paraqiten në partneritet ndërmjet dy ose më shumë institucioneve ose subjekteve të pranueshme. Institucioni koordinator duhet të jetë institucion publik i arsimit të lartë dhe mban përgjegjësinë kryesore për aplikimin, zbatimin, administrimin e marrëveshjes dhe raportimin ndaj AKKSHI.

Marrëveshja e partneritetit duhet të përcaktojë së paku:

- rolin, përgjegjësitë dhe kontributin e secilit partner;
- mënyrën e menaxhimit, vendndodhjes dhe përdorimit të infrastrukturës;
- të drejtat dhe detyrimet për pajisjet, asetet, të dhënat dhe rezultatet;
- rregullat e aksesit dhe përdorimit të përbashkët pas përfundimit të projektit;
- mekanizmat e vendimmarrjes, raportimit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe qëndrueshmërisë.

Partneriteti duhet të provojë vlerë të shtuar, veçanërisht në rritjen e kapaciteteve, shmangien e mbivendosjes së investimeve, shtimin e përdoruesve dhe krijimin e rrjeteve kërkimore. Partnerët ndërkombëtarë, institucionet jo publike të arsimit të lartë ose institucione të tjera të kërkimit shkencor dhe subjekte të tjera të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe dokumentacionit të thirrjes mund të përfshihen në partneritet pa cënuar përgjegjësinë e institucionit koordinator.

07

Kushtet e projekt propozimit

Projekt-propozimi duhet të përmbushë në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

a. të jetë në përputhje me objektivat dhe fushën e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor 2027;
b. të justifikojë nevojën për krijimin, zhvillimin, modernizimin ose zgjerimin e infrastrukturës së propozuar, duke evidentuar ndikimin në rritjen e kapaciteteve kërkimore;
c. të jetë në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin dhe Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3), sipas rastit;
d. të paraqesë një plan të qartë teknik dhe financiar për realizimin e investimit, përfshirë afatet, burimet dhe mënyrën e menaxhimit të projektit;
e. të përcaktojë mënyrën e përdorimit të infrastrukturës, përfshirë aksesin nga komuniteti shkencor dhe përdorues të tjerë të mundshëm, në përputhje me parimet e përdorimit të përbashkët dhe aksesit të hapur;
f. të përmbajë një plan për qëndrueshmërinë e infrastrukturës pas përfundimit të financimit, duke përfshirë mirëmbajtjen, kostot e funksionimit dhe kapacitetet institucionale për menaxhimin e saj;
g. të demonstrojë ndikimin e pritshëm të investimit në zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmirësimin e cilësisë së kërkimit dhe integrimin në rrjete kombëtare ose ndërkombëtare të kërkimit, kur është e zbatueshme.

08

Financimi dhe kohëzgjatja

Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) financohet nga fondet e miratuara në buxhetin e shtetit për Agjencinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), në përputhje me legjislacionin në fuqi, VKM Nr. 666, datë 12.11.2025 "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026–2028", të rishikuar dhe aktet përkatëse të miratuara nga Bordi i Administrimit për grantin e infrastrukturës.

Parametri	**Kushti i thirrjes**
FONDI I THIRRJES	633.980.400 lekë
MINIMUMI PËR PROJEKT	Nuk ka kufizim
MAKSIMUMI PËR PROJEKT	Nuk ka kufizim
KOHËZGJATJA	12 -21 muaj (jo më vonë se muaji dhjetor 2028)
DISBURSIMI	Sipas marrëveshjes së financimit dhe fondeve buxhetore

Buxheti duhet të jetë i detajuar, i argumentuar dhe proporcional me objektivat, aktivitetet dhe rezultatet.

09

Shpenzimet

Parimet e pranueshmërisë

Pranohen vetëm shpenzimet:

- që lidhen drejtpërdrejt me objektin e grantit;
- janë të domosdoshme për infrastrukturën;
- janë të arsyeshme e proporcionale;
- përfshihen në buxhetin e miratuar;
- kryhen brenda periudhës së projektit dhe mbështeten me dokumentacion të rregullt teknik, financiar dhe administrativ.

Lista përfundimtare e kategorive, kufijve dhe dokumenteve provuese përcaktohet në modelin e buxhetit dhe Aneksin 9 të dokumentacionit të thirrjes.

Shpenzimet e papranueshme

- Shpenzimet pa lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat dhe rezultatet e projektit;
- shpenzimet e kryera jashtë periudhës së pranueshme;
- pajisjet ose aktivet që nuk lidhen me infrastrukturën e propozuar;
- shpenzimet e zakonshme operative të institucionit, pagat e stafit të përhershëm dhe shpenzimet administrative, përveç rasteve të lejuara shprehimisht;
- automjetet, mobiliet e zyrës dhe pajisjet administrative të zakonshme;
- interesat, penalitetet, gjobat dhe detyrimet për mosrespektim ligjor ose kontraktual;
- kostot e financuara nga një burim tjetër publik ose program tjetër;
- shpenzimet e pambështetura me dokumentacion ose të paverifikueshme;
- shpenzime instalimi, transporti, trajnimi të stafit, etj.
- çdo kategori tjetër që nuk është miratuar në formularin financiar dhe dokumentacionin përfundimtar të thirrjes.

10

Dokumentacioni i aplikimit

Aplikimi paraqitet në gjuhën shqipe, në formatet standarde të publikuara nga AKKSHI, dhe përmban të paktën dokumentet e mëposhtme:

Nr	Dokumenti	Kërkesa kryesore
1	Shkresa zyrtare përcjellëse	E nënshkruar nga titullari ose personi i autorizuar
2	Formulari standard i aplikimit	Aneksi 1, i plotësuar në të gjitha rubrikat dhe i nënshkruar
3	Projekt propozimi	1. Plani teknik dhe shkencor i projektit; 2. Specifikime teknike; 3. Plani i punës; 4. Grafiku i punimeve; 5. Plani i vendndodhjes, instalimeve, etj; 6. Plani i riskut dhe funksionimit.
4	Analiza e nevojës dhe përdorimit	Kapacitetet ekzistuese, kërkesa e pritshme, përdoruesit dhe shmangia e mbivendosjes
5	Plani i qëndrueshmërisë	Mirëmbajtja, kostot operative, stafi, siguria dhe burimet pas financimit
6	Plani i aksesit të hapur	Rregullat e aksesit, përdorimit, tarifimit kur zbatohet dhe regjistrimit të përdoruesve
7	Plani i detajuar i punës. Kalendari i zbatimit të projektit	Aneksi 5
8	Buxheti i projekt propozimit	Aneksi 2, (sipas modelit standard 2.1. Buxheti i detajuar dhe 2.2. Argumentimi i kostove)
9	Analizë tregu për çmimet e pajisjeve	Analizë tregu për çmimet e pajisjeve në kuadër të ngritjes së laboratorit të kërkuar. Të paktën 3 oferta për cdo njësi/ pajisje
10	Prezantimi PPT i projektit	Projekti do të prezantohet përpara Bordit të Administrimit të AKKSHI
11	Dokumentet e drejtuesit të projektit	1. CV dhe 2. Vetëdeklarim i Drejtuesit të projektit që janë shlyer të gjitha detyrimet pranë AKKSHI (nëse ka qenë më parë përfitues i fondeve të AKKSHI-së)
12	Deklarata e angazhimit	Aneksi 3
13	Deklarata e mosfinancimit të dyfishtë	Aneksi 4
14	Marrëveshja e partneritetit	E detyrueshme për aplikimet në konsorcium (kur aplikohet)
15	Dokumentacioni juridik i institucionit/ partnerëve (kur aplikohet)	Në rast të aplikimit të partnerëve ndërkombëtarë, institucionet jo publike të arsimit të lartë ose institucionet jo-publike, kërkohet: a. Vërtetim nga zyra e tatim taksave, që vërteton që institucioni nuk ka detyrime të prapambetura tatimore dhe të sigurimeve shoqërore; b. Kopje të statutit apo ekstraktit të QKB ku të përcaktohet që aplikuesi ka në fokus të veprimtarisë së tij kërkimin shkencor në fushën e aplikimit dhe/ ose Vendimin e akreditimit të institucionit c. Evidenca të veprimtarisë së mëparshme kërkimore – shkencore apo pjesëmarrjes në projekte kërkimore – zhvillimore.

Dokumentet e panënshkruara, të paplotësuara ose të paraqitura jashtë formateve të detyrueshme mund të sjellin papranueshmërinë administrative të aplikimit.

11

Mënyra dhe afati i aplikimit

Veprimi	Përcaktimi
HAPJA E APLIKIMEVE	[20.11.2026]
AFATI PËR PYETJE	[22.12.2026] ora [10:00]
AFATI PËRFUNDIMTAR	[05.02.2027] ora [10:00]
KONTAKTI	programet.kombetare@nasri.gov.al | www.nasri.gov.al
DORËZIMI ZYRTAR	Zyra e protokollit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë

Aplikanti mban përgjegjësi për dorëzimin e plotë dhe brenda afatit. Aplikimet e dorëzuara pas afatit, në mënyrë të ndryshme nga ajo e përcaktuar ose pa dokumentacionin e detyrueshëm trajtohen sipas rregullave të kontrollit administrativ.

12

Sqarimet dhe komunikimi me aplikantët

Pyetjet dërgohen vetëm me shkrim në adresën [programet.kombetare@nasri.gov.al], me subjektin PIKSH 2027 | Pyetje dhe Sqarime, brenda afatit të përcaktuar. AKKSHI publikon përgjigjet dhe sqarimet me interes të përgjithshëm në faqen zyrtare, pa identifikuar pyetësin, brenda datës 22.12.2026.
Ndryshimet, plotësimet dhe sqarimet e publikuara nga AKKSHI bëhen pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes dhe janë detyruese nga data e publikimit. Informacioni i dhënë jashtë kanaleve zyrtare nuk krijon të drejta ose detyrime për palët.

13

Shqyrtimi administrativ

Pas mbylljes së thirrjes, njësia përgjegjëse e AKKSHI kontrollon:
- respektimin e afatit dhe mënyrës së dorëzimit;
- plotësimin e formularëve dhe praninë e dokumenteve të detyrueshme;
- statusin dhe pranueshmërinë e aplikantit e partnerëve;
- përmbushjen e kërkesave për partneritetin;
- përputhshmërinë formale të dokumentacionit me thirrjen.

AKKSHI mund të kërkojë plotësimin e elementeve administrative dhe formale brenda afatit të njoftuar. Plotësimi nuk mund të ndryshojë objektivat, aktivitetet kryesore, përmbajtjen teknike ose shkencore dhe vlerën apo strukturën thelbësore të buxhetit.

Aplikimi refuzohet administrativisht kur:
- dorëzohet pas afatit;
- aplikanti nuk është i pranueshëm;
- mungon dokumentacioni i detyrueshëm dhe nuk plotësohet në afat;
- nuk respektohet forma e dorëzimit;
- informacioni rezulton i rremë, i pasaktë apo mashtrues.

14

Vlerësimi shkencor, teknik dhe financiar

Projekt-propozimet që kalojnë kontrollin administrativ vlerësohen nga ekspertë të jashtëm të pavarur. Ekspertët veprojnë me paanshmëri, konfidencialitet dhe pa konflikt interesi. Vlerësimi analizon në mënyrë të integruar kriteret e mëposhtme:

FUSHA	**ELEMENTET QË VLERËSOHEN**
RËNDËSIA SHKENCORE DHE STRATEGJIKE	Nevoja e argumentuar, rëndësia për fushën, përputhshmëria me prioritetet kombëtare, kapaciteti për të mundësuar kërkim konkurrues dhe përdorimi nga komuniteti shkencor
CILËSIA DHE REALIZUESHMËRIA TEKNIKE	Përshtatshmëria e pajisjeve dhe specifikimeve, kushtet e instalimit, plani i funksionalizimit, kapacitetet njerëzore, siguria dhe mirëmbajtja
CILËSIA FINANCIARE DHE VLERA PËR PARA	Lidhja e buxhetit me aktivitetet, justifikimi dhe arsyeshmëria e kostove, raporti kosto përfitim, kostot operative dhe shmangia e financimit të dyfishtë
NDIKIMI PËRDORIMI DHE AKSESI	Numri dhe profili i përdoruesve, bashkëpunimi, shërbimet e pritshme, aksesi i hapur, lidhja me sektorin privat dhe rrjetet kombëtare ose ndërkombëtare
QËNDRUESHMËRIA DHE KAPACITETI INSTITUCIONAL	Pronësia dhe qeverisja, mirëmbajtja, financimi pas projektit, menaxhimi i të dhënave, KPI dhe përdorimi afatgjatë

15

Renditja, prezantimi, miratimi dhe publikimi i rezultateve

Pas përfundimit të vlerësimit, AKKSHI konsolidon rezultatet, rendit projekt-propozimet, përcakton vlerën e financimit dhe kushteve eventuale të zbatimit, përgatit metodologjinë për vlerësimin e projekteve fituese, duke marrë në konsideratë analizën e aplikimeve të administruara, pikët, fondet e disponueshme dhe kushtet eventuale të zbatimit. Drejtori i Përgjithshëm ia përcjell dokumentacionin Bordit të Administrimit të AKKSHI për vendimmarrje.

IAL/ Drejtuesit e projekteve prezantojnë përpara Bordit të Administrimit të AKKSHI konceptin e propozimit të tyre.

Në përfundim, Bordi i Administrimit miraton projektet fituese, institucionet përfituese dhe vlerën e financimit. AKKSHI njofton aplikantët dhe publikon rezultatet në faqen zyrtare, në përputhje me transparencën, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave.

16

Ankimi

Aplikanti mund të paraqesë ankim me shkrim brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i rezultatit, në mënyrën e përcaktuar nga AKKSHI. Ankimi shqyrton respektimin e procedurave të administrimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes. Ai nuk shërben për rivlerësimin e meritës shkencore, përveç rasteve kur pretendohet dhe provohet një shkelje procedurale që mund të ketë ndikuar në rezultat.

17

INFORMACIONE TË TJERA

1. Aplikantët duhet t'i referohen Udhëzuesit për menaxhimin e projekteve të Programit kombëtar TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR – PIKSH 2027, ku do të gjejnë udhëzime dhe detaje specifike lidhur me procesin e aplikimit, vlerësimit dhe financimit.
2. Udhëzuesin dhe ankeset e aplikimit mund t'i gjeni në faqet zyrtare: https://www.arsimi.gov.al dhe https://www.nasri.gov.al
3. Gjatë periudhës që thirrja qëndron e hapur, AKKSHI, në bashkëpunim me IAL-të, zhvillon aktivitete informuese dhe orientuese për aplikantët potencialë.
4. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programin ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresën: programet.kombëtare@nasri.gov.al
5. Të dhënat personale të aplikantëve përpunohen vetëm për administrimin, vlerësimin dhe monitorimin e programit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar konfidencialitetin, sigurinë dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllimet e përcaktuara.
6. Kalendari orientues i thirrjes:

Kalendari orientues

FAZA	**AFATI**
PUBLIKIMI I THIRRJES	20.11.2026
SESIONE INFORMUESE	30.11.2026 - 11.12.2026
AFATI PËR PYETJE	22.12.2026
AFATI PËR APLIKIM	05.02.2027
KONTROLLI ADMINISTRATIV	12.02.2027
VLERËSIMI SHKENCOR, TEKNIK DHE FINANCIAR	26.02.2027
PREZANTIMI I PROJEKTEVE PËRPARA BA	01.03.2027 – 09.03.2027
VENDIMMARRJA DHE NJOFTIMI	10.03.2027 – 12.03.2027
AFATI PËR ANKESA	brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit
NËNSHKRIMI DHE FILLIMI I ZBATIMIT	Deri 31.03.2027

Shënim:
Ditët numërohen kalendarike.
Afatet e brendshme të AKKSHI-së mund të ndryshojnë me njoftim publik.